

[Printo]

[Google Translate]

LIGJ

Nr. 10 169, datë 22.10.2009

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9482, DATË 3.4.2006 "PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 17/1

Mënyra e pagesës së parcelës ndërtimore të ndërtimit pa leje

1. Pagesa e vlerës së parcelës ndërtimore të ndërtimit pa leje, në proces legalizimi, bëhet:

a) në lekë, në vlerë të plotë monetare;

b) me bono privatizimi, në përputhje me dispozitat e neneve 19, 20 e 21 të këtij ligji.

2. Bonot e privatizimit, të përfituara nga ish të përndjekurit politikë dhe nga subjektet e tjera gjatë procesit të privatizimit të pronës shtetërore, kanë të njëjtin trajtim me bonot e tjera të privatizimit.

3. Taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera financiare, që lidhen me kalimin e së drejtës së pronësisë, bëhen vetëm në lekë."

Neni 2

Në nenin 19, në fund të shkronjës "dh" shtohen fjalët "dhe, deri në 50 për qind të vlerës, pagesa mund të kryhet me bono privatizimi."

Neni 3

Në nenin 20, në fund të shkronjës "ç" shtohen fjalët "dhe, deri në 50 për qind të vlerës, pagesa mund të kryhet me bono privatizimi."

Neni 4

Në nenin 21, në fund të shkronjës "ç" shtohen fjalët "dhe, deri në 50 për qind të vlerës, pagesa mund të kryhet me bono privatizimi."

Neni 5

Në nenin 22 paragrafi i parë, pas fjalëve "zbatohen të njëjtat tarifa" shtohen fjalët "dhe mënyra pagese".

Neni 6

1. Në nenin 27, pas shkronjës "ë" shtohet shkronja "f" me këtë përmbajtje:

"f) kërkesë e subjektit për mënyrën e pagesës së parcelës ndërtimore të ndërtimit pa leje, në përputhje, përkatësisht, me nenet 19, 20 ose 21 të këtij ligji."

Neni 7

Në nenin 32, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Të ardhurat e arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelave ndërtimore transferohen në

Buxhetin e Shtetit për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si fond kompensimi financiar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar."

Neni 8

Dispozita kalimtare

1. Personat, të cilët i kanë kryer pagesat për parcelat ndërtimore të ndërtimit pa leje përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfitojnë lehtësitë e parashikuara në këtë ligj.
2. Për të përfituar nga e drejta e pagesës me bono privatizimi për pjesën e mbetur të detyrimit apo për rikthimin e shumave të paguara në lekë, në këmbim të dorëzimit të bonove të privatizimit, personat duhet të paraqesin kërkesë, me shkrim, pranë ALUIZNI-it brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Procedurat dhe afatet e rimbursimit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6320, datë 5.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Copyright 2012 - www.ligjet.org